



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Komuna e Lipjanit

Thirrja për aplikim

Udhëzimet për Aplikantët

Sipas Rregullores MF - NR – 04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve,

Data e hapjes së thirrjes: **13.11.2024**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: **27.11.2024**

Përmbajtja

1. Thirrja për aplikim- Komponenta e Kulturës dhe Rinisë,	
1.1 PROBLEMET TË CILAT SYNOHET TË ADRESOHEN PËRMES KËSAJ THIRRJE PUBLIKE	Error! Bookmark not defined.
1.2 OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE... 3	
1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES	Error! Bookmark not defined.
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES	4
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?	4
2.2 Partnerët e pranueshme në zbatimin e projektit/programit	4
2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes	5
2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes.....	6
2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme.....	6
2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme.....	7
2.4.3 Shpenzimet e papranueshme	Error! Bookmark not defined.
3. SI TË APLIKONI?.....	Error! Bookmark not defined.
3.1 Forma e përshkruese e projektpropozimit.....	8
3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit	9
3.3 Ku ta dorëzoni aplikimin?	9
3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve.....	10
3.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?	10
4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE	10
4.1 Aplikacionet e pranura do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:.....	10
4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi	11
5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES	12
6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE	12

Thirrja për aplikim- Objektivi Strategjik i Komponentes

1. OBJEKTIVAT E THIRRJES DHE PRIORITETET PËR NDARJEN E FONDEVE

Objektivi i përgjithshme i kësaj Thirrje është:

3. *Drejtorati për Kluturë, Rini dhe Sport* u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare (**Klubet sportive, Shkollat Sportive dhe Shoqatat Sportive**) me seli dhe adresë në komunën e Lipjanit, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në objektivit të përgjithshëm : **Zbulimin dhe promovimin e talenteve të rinj të SPORTIT në Komunën e Lipjanit.**

Objektivat specifike të kësaj Thirrje janë:

- Rezultatet e klubeve
- Gjithpërfshirja
- Zbulimi i talenteve
- Zhvillimi psiko-fizik i te rinjve dhe femijeve

Prioritet për ofrimin e mbështetjes financiare publike do të kenë:

- Avancimin dhe fuqizimin e sportit në Komunën e Lipjanit, rezultate të kënaqeshme, zbulimi i talenteve të rinjë.

OJQ-të të cilat:

1. Bëjnë përfshirjen e profesionistëve nga fusha e ngritjes së kapaciteteve për të zbatuar pjesët profesionale;
2. Kanë qenë korrekte në zbatimin dhe raportimin e projekteve të financuara nga DKRS-ja

1.3 VLERA PLANIFIKUAR E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PROJEKTET DHE TOTAL I THIRRJES

1. Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj Thirrjes Publike është paraparë shuma në dispozicion prej 30,000.00€
2. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt është 501.00€, ndërsa shuma maksimale është 3,000.00€

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ -të SHKOLLAT SPORTIVE, KLUBET SPORTIVE DHE SHOQATAT SPORTIVE, që mirren me zbullimin e talentëve të rijë, që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës para datës së publikimit të kësaj thirrje publike të cila zhvillojnë aktivitete përkatëse dhe të cilat veprojnë në **Komunën e Lipjanit**.

Shkollat Sportive, Klubet Sportive dhe Shoqatat Sportive aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Sportit dhe aktiviteteve të komponentes së pjesëmarrjes. **Klubet sportive, Shkollat Sportive dhe Shoqatat Sportive** duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit për Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, Klubet Sportive, Shkollat Sportive dhe Shoqatat Sportive duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës (i autorizuari) në Klubin Sportiv, Shkolla Sportive dhe Shoqaten Sportive nuk është nën hetime për vepra penale.

Klubet Sportive, Shkollat Sportive dhe Shoqatat Sportive nuk mund të aplikojnë me më shumti se një (1) projekt në kuadër të kësaj thirrje, i cili mund të mbulojë fushën prioritare të specifikuar sipas thirrjes.

Klubet Sportive, Shkollat Sportive dhe OJQ-të të cilat kanë Kontrata të hapura dhe të pa arsyetuara nuk mund të jenë përfitues të kësaj thirrje.

Periudha e zbatimit të projektit është për datat e caktuara të veprimtarive SPORTIVE që janë të planifikuara me Plan vjetor të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

2.2 Partnerët e mundshëm në zbatimin e projektit/programit

Partneriteti me organizata të tjera është i preferueshëm dhe nuk është i detyrueshëm, gjithashtu e njëjta organizatë mund të marrë pjesë në më shumë se një projekt.

Partneriteti përfshinë marrëdhëniet mes OJQ-ve që nënkupton përgjegjësi në zbatimin e programit/projektit të financuar nga ofruesit e mbështetjes financiare. Në mënyrë që projekti/programi të zbatohet pa probleme, të gjitha organizatat që janë pjesë e partneritetit duhet të pajtohen me parimet e praktikës së mirë në partneritet:

Kushtet e Partneritetit

1. Para dorëzimit të aplikimit tek ofruesi i mbështetjes financiare, të gjithë partnerët do të lexojnë tekstin e thirrjes publike dhe udhëzimet për dorëzimin e aplikacioneve dhe të kuptojnë rolin e tyre në projekt/program.
2. Të gjithë partnerët autorizojë Aplikuesin për t'i përfaqësuar ata në të gjitha marrëdhëniet me ofruesin e mbështetjes financiare në kontekstin e zbatimit të projektit/programit.
3. Aplikuesi dhe të gjitha organizatat partnere do të takohen rregullisht dhe të punojnë së bashku për zbatimin e projektit/programit, vlerësimin dhe shqyrtimin e mënyrave për tejkalimin e sfidave dhe vështirësive në zbatimin e projektit.
4. Të gjithë partnerët do të marrin pjesë në përgatitjen e pasqyrave të përbashkëta përshkruese dhe të veçanta financiare, dhe aplikuesi në emër të të gjithë partnerëve paraqet ato tek ofruesi i mbështetjes financiare.

Propozimi për ndryshime në partnerët e projektit duhet të bëhet me marrëveshje në mes të partnerëve, ndërsa aplikuesi e dorëzon atë tek ofruesi i mbështetjes financiare

2.3 Aktivitetet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Aktivitetet e pranueshme për t'u mbështetur janë:

- Aktivitetet që janë të bazuara në fushat prioritare në bazë të thirrjes së publikuar dhe të specifikuar si më poshtë :
4. Organizatat jo-qeveritare (**KLUBET SPORTIVE, SHKOLLAT SPORTIVE dhe OJQ-të SPORTIVE** , mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në : ***Zbulimin dhe promovimin e talentëve të rinj të SPORT të Komunën e Lipjanit.***

5. Specifikacioni :

Nr.	Emërtimi	Shuma në € NGA	Shuma në € DERI
1.	Klubet e futbollit, kategorit e reja	501.00	30000.00
2.	Klubet e basketbollit, kategorit e reja	501.00	2800.00

3.	Klubet e volibollit, kategorit e reja	501.00	2500.00
4.	Klubet e hendbollit, kategorit e reja	501.00	2000.00
5.	Klubet e pingpongut, kategorit e reja	501.00	1500.00
6.	Klubet e atletikes kategorit e reja	501.00	1000.00
7.	Klubet e baletit, kategorit e reja	501.00	1000.00
8.	Klubet e shahut, kategorit e reja	501.00	800.00
9.	Shoqatat sportive te cilat zbulojn talent të rinjë	501.00	2800.00
10.			
11.			
12.			
13.			

Llojet e më poshtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:

Nuk financohen aktivitetet që zgjasin më pak se **240 ditë (8 muaj)**, inventari, qiraja për zyre, komunalit si dhe nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që tek të rinjtë mund të kenë ndikim politik, religjioz etj. Nuk do të përkrahen projekt-propozimet e OJQ-ve që në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Komunën e Lipjanit kanë avance të pa mbyllura, si dhe nuk do të shqyrtohen projekt-propozimet me dokumentacion të pakompletuar.

2.4 Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes fondeve publike të kësaj thirrje publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit/programit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

2.4.1 Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkt përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

a) Pagesa e referimit për ndeshjet zyrtare

- b) **Pagesa e transportit për ndeshje zyrtare** (në qoftë se paraqet derivate, jo ma shum se 12 litra në 100km)
- c) **Pagesa e ushqimit dhe pijeve për ndeshje zyrtare** (gjdo fatur mbi 100 euro të jetë transfer bankar)
- d) **Pagesa e regjistrimit dhe kootizimit në Federatat përkatëse**
- e) **Pagesa për blerje të rekuizitave sportive** (çdo fatur mbi 100 euro të jetë transfer bankar)
- f) **Pagesa për ekipin mjekesor gjatë ndeshjeve zyrtare** (I regjistruar ATK, ose kontrat mbi mardhanjen e punes ne klub me kontribute te paguara në ATK)
- g) **Pagesen e asistimet e Policisë gjatë ndeshjeve zyrtare** (Transfer bankar)
- h) **Pagesa deri në 30 % nga shuma totale e subvencionur për paga për staf profesional** (Të jen te realizuara transfer bankar)

Të gjitha këto pozicione do të financohen nga ofruesi i subvencionit

Sipas përshkrimit në formularin e buxhetit:

Nëpërmjet fondeve publike të kësaj ftese publike mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit, në periudhën kohore të specifikuar me këto udhëzime. Në vlerësimin e projektit do të vlerësohen vetëm kostot e nevojave në lidhje me aktivitetet e planifikuara, si dhe në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve.

1. 2.4.2 Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzimeve të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte (përqindje e vlerës totale të projektit/programit). Në kuadër të këtyre shpenzimeve përfshihen kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit. Edhe këto kosto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen.

2.4.3 Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

- Shpenzimet për aktivitetet që zgjasin më pak se 8 muaj
- Shpenzimet për blerje të inventarit,
- Qiraja për zyre,
- Komunalitë,
- Nuk përkrahen projektet e OJQ-ve që tek të rinjtë (SPORTISTET) që mund të kenë ndikim politik, religjioz etj.
- Nuk do të përkrahen projekt-propozimet e OJQ-ve që në Drejtorat për Kulturë, Rini dhe Sport dhe në Komunën e Lipjanit kanë avance dhe kanë kontrata me DKRS-në të pambyllura, si dhe nuk do të shqyrtohen projekt-propozimet me dokumentacion të pakompletuar.

3. SI TË APLIKONI?

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare <https://kk.rks-gov.net/lipjan/>

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën e mëposhtme:

KOMUNA E LIPJANIT

Rruga „Shqipëria”

Zyra për shërbim të qytetarëve

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë** dhe përfundon me datën **27.11.2024**

Aplikimi i OJQ-ve do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i Aplikacionit për projekt/programit
2. Formulari i Propozim buxhetit
3. Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë
4. F13 Forma e deklaratës se projekteve te financuara
5. Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit,
6. Certifikata e nr fiskal,
7. Konfirmimi(dëshmia) mbi llogarinë bankare (e shtypur)
8. Dëshmi nga Federata (**VERTETIM, KONFIRMIM, CERTEFIKATË**) përkatëse me të cilin vërtetohet se Klubi bënë gara.
9. Deklaratë e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të deklaruara në ATK për vitin 2023
10. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e obligimeve apo borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh publik apo ka ndonjë marrëveshje për shlyerje të obligimeve apo borxhit publik;
11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës (i autorizuari) në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale,.

3.1. Forma përshkruese projekt propozimit:

Plotësimi i formularit të projekt propozimit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merren në konsideratë. Nëse forma përshkruese përmban të meta si më sipër, aplikimi do të konsiderohet i pavlefshëm.

3.2 Përmbajtja e formës Buxhetit

Formulari i propozim Buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Propozim Buxheti i dorëzuar duhet të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë.

3.3 Ku dhe si ta dorëzoni aplikacionin?

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (një origjinal) dhe në formë elektronike (në CD ose USB). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD ose USB) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD ose USB duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikacioni origjinal duhet të dërgohet me postë ose në person (dhe të dorëzohet në Zyrën përkatëse). Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe shënimin "*Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues*".

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Komuna e Lipjanit
Zyra e për shërbim me publikun, sporteli nr. 3
Rruga „Shqipëria”

"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit
Vlerësues"

3.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati i thirrjes është deri më: **27.11.2024, ora 16.00h**. Kërkesa është dorëzuar brenda periudhës së thirrjes nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së thirrjes, si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në Zyrë, aplikanti do ti lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

1.5 Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje?

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar një kërkesë në adresën e mëposhtme: mergim.oruci@rks-gov.net jo më vonë se 8 ditë para skadimit të thirrjes.

Për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve të mundshëm, një ofrues i mbështetjes financiare publike nuk mund të japë një mendim paraprak për pranueshmërinë e aplikantëve, partnerët, veprimet apo shpenzimet e përmendura në kërkesë.

2. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

1.1 Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme:

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes financiare do të themeloj një komision vlerësues të përbërë nga 5

anëtarë nga zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësoj aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës.

Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

4.2 Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni për konkurrencën, një ofrues i burimeve financiare do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, ofruesi mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Dokumentacioni shtesë: Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës (i autorizuari) në OJQ nuk është nën hetime për vepra penale.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së *caktuar (jo më pak se 5 ditë)*, aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse, pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse dhe pasi të konstatohet nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve/programeve në kuadër të thirrjes.

3. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes (vendosni datat)

1. Afati i fundit për aplikimet 27.11.2024
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen 17.11.2024
3. Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen 22.11.2024
4. Afati i fundit për verifikimin e përmbushjes së kriterëve procedurale dhe njoftimit të palëve (sipas rregullores se MF 04/2017)
5. Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtjesore (sipas rregullores se MF 04/2017)
6. Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë (sipas rregullores se MF 04/2017)
7. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar (sipas rregullores se MF 04/2017)
8. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve (sipas rregullores se MF 04/2017)
9. Afati për kontraktim (sipas rregullores se MF 04/2017)

4. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIK FORMULARËT

1. *Formulari i Aplikacionit për projekt/programit (word)*
2. *Formulari i Propozim buxhetit (format Excel)*
3. *Formulari i deklaratës për mungesë të financimit të dyfishtë (format word)*
4. *F13 Forma e deklaratës se projekteve të financuara për vitet 2022 dhe 2023 (e shtypur dhe CD)*
5. *Dokumentacionet e OJQ-së: Certifikata e regjistrimit,*
6. *Certifikata e nr fiskal,*
7. *Konfirmimi (dëshmia) mbi llogarinë bankare (e shtypur)*
8. *Dëshmi (VERTETIM, KONFIRMIM, CERTEFIKATË) nga Federata përkatëse me të cilin vërtetohet se Klubi bënë gara.*
9. *Deklaratë e dorëzimit të pasqyrave financiare vjetore të deklaruara në ATK për vitin 2023;*

10. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e obligimeve apo borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh publik apo ka ndonjë marrëveshje për shlyerje të obligimeve apo borxhit publik;
11. Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës(i autorizuari) në OJQ Klub nuk është nën hetime për vepra penale.

Vërejtje : të gjithë këta formularë duhet të shtypen një origjinal futet në zarf, e njëjtat duhet të skanohen dhe vendosen në CD ose USB.